



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije
Ministry of Education, Science and Technology

O F E R T Ë

Për angazhimin e ekspertëve lëndorë për hartimin e kërkesave të testeve për vlerësime të jashtme (Testi i Arritshmërisë-Klasa 9-të, Matura Shtetërore dhe Vlerësimi për Shkallë).

Në pajtim me detyrat dhe përgjegjësitë e DVSM për të formuar listën e anëtarëve të komisioneve të lëndëve për përpilimin e kërkesave për Testin e Arritshmërisë -Klasa 9-të, Maturës Shtetërore dhe Vlerësimin për Shkallë me qëllim të zhvillimit transparent dhe ligjor të procesit të përzgjedhjes së kandidatëve, MASHt shpallë ofertë për përzgjedhjen e ekspertëve lëndorë, të cilët duhet të plotësojnë këto kritere:

1. Të jetë mësimdhënës i rregullt i shkollës/universitetit;
2. Të ketë së paku 5 vite përvojë pune në arsim;
3. Të jetë i lëmesë/fushës përkatëse, për të cilat është i thirrur për përpilimin e kërkesave të testit.
4. Të ketë marrë pjesë në trajnim në hartimin e testeve të standardizuara për vlerësim të organizuara nga DVSM-MASHt;
5. Të ketë përvojë në përpilimin e testeve në vlerësime të jashtme;
6. Të njohë mirë kurrikulën dhe të ketë aftësi për hartimin e kërkesave sipas hierarkisë së niveleve të dijes të ndonjë taksonomije;
7. Të njohë mirë përdorimin e kompjuterit;
8. Të jetë person kredibil dhe konfident;
9. Të respektojë marrëveshjen me përpikëri;
10. Të respektojë detyrat e përcaktuara:
 - Përgatitë bankën e kërkesave për lëndën përkatëse;
 - Bën rishikimin e plan-programeve;
 - Përzgjedhë përmbajtjet programore, të cilat ai i konsideron se duhet vlerësuar;

- Formon tabelën e specifikave me shpërndarje standarde;
- Kërkesat i përgatitë bazuar në plan dhe program;
- Konsulton tekstet shkollore;
- Kërkesat e testit dorëzohen në formë elektronike dhe në letër të nënshkruara dhe janë me fond shkronjash 12-të dhe figura të qarta;
- NUK lejohet dërgimi me internet i kërkesave;
- Secila kërkesë rishikohet dhe miratohet nga koordinatori;
- Mbanë përgjegjësi për saktësinë e kërkesave;
- Koordinon dhe ndihmon punën e tij me grupin përkatës të ekspertëve lëndorë;
- Shënimet dhe puna e tij dorëzohet në fletë dhe me formë elektronike;
- Kërkesat e hartuara i rishikon me koordinatorin e grupit;
- Detyrat dhe obligimet i dorëzon me afat kohor të përcaktuar nga koordinatori i DVSM/ MAShT;
- Mbanë përgjegjësi për besueshmëri të plotë për punën e bërë;
- Bën përkthimin e kërkesave në gjuhë amtare (për minoritete për lëndën e caktuar);
- Numri i kërkesave të dorëzuara është i caktuar sipas kriterëve që i cakton koordinatori i DVSM;
- Jep përgjegjësi për çfarëdo lëshimi nga ajo që është caktuar me marrëveshje.

Si më sipër, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, bazuar në legjislacionin në fuqi, do të marrë vendim për angazhimin e ekspertëve të poshtëshënuar sipas fushave:

Gjuhë shqipe:

3 persona për nivelin kl. 9-të

4 persona për nivelin e Maturës

Gjuhë turke:

3 persona për nivelin kl. 9-të

4 persona për nivelin e Maturës

Gjuhë boshnjake:

3 persona për nivelin kl. 9-të

4 persona për nivelin e Maturës

Gjuhë angleze:

2 persona për nivelin kl. 9-të

2 persona për nivelin e Maturës

Gjuhë e dytë e huaj:

1 person për gjuhë gjermane

1 person për gjuhë frënge

Matematikë:

3 persona për nivelin kl. 9-të

4 persona për nivelin e maturës

Shkenca shoqërore dhe ekonomi:

Histori

2 persona për nivelin kl. 9-të

2 persona për nivelin e Maturës

Gjeografi

2 persona për nivelin kl. 9-të

2 persona për nivelin e Maturës

Ekonomi

2 persona për nivelin e Maturës

Sociologji

2 persona për nivelin e Maturës

Psikologji

2 persona për nivelin e Maturës

Edukatë qytetare

2 persona për nivelin e Maturës

Shkenca natyrore

Fizikë

2 persona për nivelin kl. 9-të

2 persona për nivelin e Maturës

Kimi

2 persona për nivelin kl. 9-të

2 persona për nivelin e Maturës

Biologji

2 persona për nivelin kl. 9-të

2 persona për nivelin e Maturës

Informatikë

1 person për nivelin kl. 9-të

2 persona për nivelin e Maturës

Arti dhe Muzika

Art

2 persona për nivelin e Maturës

Muzikë

2 persona për nivelin e Maturës

Përkthim në gjuhë turke për dy nivele

1 person për shkenca shoqërore

1 person për shkenca natyrore

1 person për matematike dhe informatikë

Përkthim në gjuhë boshnjake për dy nivele

1 person për shkenca shoqërore

1 person për shkenca natyrore

1 person për matematike dhe informatikë

Nga të përzgjedhurit në çdo fushë do të jenë edhe nga Universiteti.

Kohëzgjatja e *marrëveshjes* brenda një viti për një ekspert do të specifikohet varësisht nga volumi i pyetjeve në një lëndë.

Varësisht nga angazhimi i ekspertëve *marrëveshja* mund t'i vazhdohet edhe për vitet pasuese.

Oferta mbetet e hapur deri më 29.01.2018.

Aplikacionet dorëzohen në MASHT në zyrën arkivuese.